



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.5.2023

Nr: 461

Ora: 12:30

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 391 NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR
KOALICIONI "BASHKË FITOJMË" PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NË
KUNDËRSHTIM TË LIGJIT NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" NË
BASHKINË ELBASAN**

Sot më datë 6 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Subjekti Zgjedhor Koalicioni "Bashkë Fitojmë"

OBJEKTI: Kërkohej heqja e materialit propagandistik të vendosur nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" në qytetin e Elbasanit

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" e "n", e pika 2, dhe neni 79, pika 2, i Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me denoncues subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Denoncimi është regjistruar me nr. 391 ID të regjistrit të denoncimeve. Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohet se: *“Në lagjen Kongresi Elbasanit, Rruga Alush Lleshanaku, përballë Poliklinikës, në fasadën e një pallati banimi, me përmasa përafërsisht 10 m të gjatë dhe 3 metra të gjerë, është afishuar material propagandistik nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.*

Pala kërkuese kërkon heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike të vendosura në kundërshtim me ligjin.

Në përgjigje të këtij denoncimi, KQZ filloi hetimin administrativ përkatës. Në kuadër të këtij hetimi administrativ, monitoruesit të caktuar nga KQZ-ja në Bashkinë Elbasan, nëpërmjet postës elektronike e-mail, ju kërkua informacion në lidhje me afishimin e këtij materiali propagandistik. Nga informacioni i administruar vërtetohet fakti i denoncuar.

Nga analiza ligjore, konkludohet se bazuar në nenin 3, pika 2, të udhëzimit nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndalohet afishimi i materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore në fushatë, nuk mund të vendosen në fasadat e godinave të banimit institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.

Në zbatim të nenit 79 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr. 6/2021, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka njoftuar nëpërmjet e - mailit me datë 06.05.2023 subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për heqjen e materialit propagandistik. Subjekti zgjedhorë nuk ka zbatuar kërkesën e KQZ-së dhe

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, dhe nenin 79, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëherëshme të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në fasadën e një pallati banimi, përballë Poliklinikës, në lagjen “Kongresi Elbasanit”, Rruga “Alush Lleshanaku”, në bashkinë Elbasan.
2. Ngarkohen Policia Bashkiake Elbasan, Policia e Shtetit për zbatimin e menjëhershëm të këtij vendimi.

Data: 6.5.2023 Nr: 461
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr 391 nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë” për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në Bashkinë Elbasan”

3. Ky vendim u njoftohet subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit si dhe Policisë Bashkiake Elbasan nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI